



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:211158  
Datë: 09.10.2024  
Numri i dokumentit: 06270356

Ac.nr.768/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Naim Mehollli dhe Rafet Haxhaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.B, nga fshati R....., Komuna e K....., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat T.R, kundër të paditurës Komuna e Klinës–Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë punës dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.641/21, të datës 07.12.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 07.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Klinës- Drejtoria Komunale e Arsimit DKA, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.641/21, i datës 07.12.2022, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.641/21, të datës 07.12.2022, ka vendosur si në vijim: “*APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.B, nga fshati R.....Komuna e K..... DETYROHET e paditura Komuna e Klinës – Drejtoria e Arsimit, që paditëses t’ia paguajë në emër të kompensimit për ushqim - shujtave gjatë ditëve të punës, shumën prej 234.00 euro, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datë 02.07.2021, apo gjithsejtë për 117 ditë pune, si dhe në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit shumën prej 245.70 euro, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datën 02.07.2021, apo gjithsejtë për 117 ditë pune, shuma e përgjithshme në lartësi prej 479.70 euro, me kamatë ligjore, në lartësi prej 8 % në vit, duke filluar llogaritja e kamatës nga data 21.09.2021, dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë, në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedure, në shumë prej 124.00 euro (njëqind e njëzet e katër), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja-pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit”.*

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes të autorizuarit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën dhe ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe të hedhë poshtë padinë e paditësit ose të njëjtin ta ndryshoj ashtu që lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesën nuk ka parashtruar pala paditëse.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja përmes përfaqësuesit të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë me datë 21.09.2021, ka paraqitur padi për kompensimin e ushqimit gjatë punës dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit kundër të paditurës Komuna e Klinës-Drejtoria e Arsimit. Në padi i autorizuari i paditëses ka theksuar se paditësja është e punësuar sipas kontratës së punës me Nr.proto.04-112-6458/21 e datës 22.02.2021, te e paditura, në SH.M.U “.....” në fshatin B....., Komuna e K..... dhe nga data 14.09.2020 e deri me datë 02.07.2021, ka realizuar gjithsejtë 117 ditë të pranisë në punë për të cilat kërkon kompensimin e ushqimit ndërsa nga hyrja në fuqi e kontratës sektoriale me datë 18.04.2017 e gjerë me datën 02.07.2021, ka realizuar gjithsejtë 117 ditë ku për çdo ditë pune, e njëjta udhëton përmes transportit urban nga B....., Komuna e K....., për të cilat ditë kërkon kompensim pasi që asnjëherë nuk është kompensuar nga e paditura.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, rregullimit të saj, pa shqyrtim të çështjes, në bazë të nenit 398 të LPK-së, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.641/21 të datës 07.12.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se Mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura. Gjykata e shkallës së parë përmes vërtetimit të lëshuar nga e paditura mbi ditët e prezencës në punë të paditëses lidhur me shpenzimet e ushqimit dhe të udhëtimit vërtetoi faktin se sipas vërtetimit me Nr.prot.35/21, i datës 01.07.2021, paditësja nga data 14.09.2020 e gjerë me datën 02.07.2021, ka realizuar gjithsejtë 117 ditë pune për të cilat kërkon kompensimin e ushqimit ndërsa nga data 18.04.2017, dita kur kontrata kolektive ka hyrë në fuqi e deri me datë 02.07.2021, ka realizuar gjithsejtë 117 ditë pune për të cilat kërkon kompensim për udhëtim, ndërsa me vërtetimin e lëshuar nga Agjensia e Udhëtimit “Xh.....”, me datë 28.06.2021, vërtetohet se paditësja për çdo ditë të punës udhëton nga fshati R..... për në qytetin e K..... kurse me vërtetimin e lëshuar nga Agjensia e Udhëtimit “SHPK-F.....”, i lëshuar me datë 28.06.2021, vërtetohet se paditësja për çdo ditë të punës udhëton nga qyteti i K..... për në fshatin B..... Të cilat vërtetime gjykata i pranoi si provë materiale, në kuptim të Nenit 329 par.1 të LPK-së, ngase

vërtetimi për ditët e prezencës në punë të paditëses është dokument i lëshuar nga vet e paditura, respektivisht institucionet shkollore që veprojnë në kuadër të paditurës, brenda fushëveprimit të saj. Andaj, vërtetimet si provë me të cilin vërtetohen faktet lidhur me ditët e prezencës në punë dhe lidhur me udhëtimin e paditëses, gjykata u'a fali besimin e plotë.

Lidhur me mënyrën e vendosjes vendimin e bazoi në nenin 35 paragrafi 5 dhe 7 të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe datës 22.01.2021. Për kamatën ka vendosur konform nenit 382.2 të LMD-së dhe vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në nenin 452 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika e), se është vendosur për kërkesën sipas padisë të ngritur pas afatit të përcaktuar me ligj dhe pika n), se nuk ka dhënë arsye bindëse për faktet vendimtare, nuk ka paraqitur qartë se cilat arsye i trajton si të vërteta apo të pavërteta. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, këto pretendime të autorizuarit të paditurës janë të pabazuara për arsye se në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës ku përcaktohet se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”* në rastin konkret paditësja padinë e ka paraqitur me datën 21.09.2021 dhe nuk kemi jashtafatshmëri të kërkesës, ndërsa dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin duke dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me faktet thelbësore, provat e administruara dhe zbatimin e të drejtës materiale.

Nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi është nxjerr pa u plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 398 të LPK-së, sepse në rastin konkret janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për marrjen e të njëjtit sipas nenit 152 lidhur me nenin 398 të LPK-se.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestues fakti që paditëses i takon kompensimi për ushqim dhe udhëtim pasi që sipas vërtetimit me Nr.prot.35/21, i datës 01.07.2021, paditësja nga data 14.09.2020 e gjerë me datën 02.07.2021, ka realizuar gjithsejtë 117 ditë pune për të cilat kërkon kompensimin e ushqimit ndërsa nga data 18.04.2017, dita kur kontrata kolektive ka hyrë në fuqi e deri me datë 02.07.2021, ka realizuar gjithsejtë 117 ditë pune për të cilat kërkon kompensim për udhëtim, ndërsa me vërtetimin e lëshuar nga Agjensia e Udhëtimit “Xh.....”, me datë 28.06.2021, vërtetohet se paditësja për çdo ditë të punës udhëton nga fshati R..... për në qytetin e K..... kurse me

vërtetimin e lëshuar nga Agjensia e Udhëtimit “SHPK-F.....”, i lëshuar me datë 28.06.2021, vërtetohet se paditësja për çdo ditë të punës udhëton nga qyteti i K..... për në fshatin B.....

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se: Me nenin 90 par. 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 4 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive*”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*”.

Gjykata e Apelit vlerëson se kërkesëpadia e paditësit lidhur me kompensimin e ushqimit dhe kompensimin e udhëtimit gjen mbështetje në nenin 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit ku theksohet se: “*Punonjësve arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*”, dhe par.7 ku theksohet se: “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet e arsimore*”. Duke pasur parasysh se paditësi i ka ditët e pranisë në punë për periudhën 18.04.2017 deri më datën 02.07.2021 si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ku shihet qartë se paditësit i takon shpërblimi i vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në përputhje me Kontratën Kolektive të Arsimit, lidhur me të drejtën e paditësit për kompensimin e ushqimit dhe kompensimin e udhëtimit për faktin se i padituri ka vepruar në kundërshtim me nenin e sipërcituar, duke mos ia kompensuar paditësit shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit që iu takojnë, sipas KKA-së, e që ky aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes është marrë drejtë nga gjykata e shkallës së parë pasi që janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për marrjen e të njëjtit sipas nenit 398 të LPK-së, prandaj i njëjti vërtetohet në tërësinë e tij.

Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “*MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9.*”

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtës ditore) gjatë ditëve të pranisë në punë dhe udhëtimit, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se:

*“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës lidhur me atë se e paditura nuk ka për detyrim të paguajë shpenzimet e ushqimit, pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e këtyre kontratave me ç‘rast të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e datës 18.04.2017 dhe 21.01.2021 përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”.*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo-arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura ti përmbushë, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit bien të paditurën e cila është e detyruar ta përmbushë një detyrim të tillë, andaj edhe një pretendim i tillë del të jetë i pathemeltë të cilin gjykata ankimore vendosi ta refuzojë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë lidhur me kamatën e gjykuar drejtë ka vendosur duke u bazuar në nenin 382.2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.768/2023, me datë 07.10.2024

Kryetar i kolegjit - Gjyqtari  
Qerim Ademaj, d.v.